

VENDIM
Nr.1215, datë 16.12.2009

PËR NJË SHTESE NË VENDIMIN NR.1151, DATË 25.11.2009
TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE “PËR KRIJIMIN DHE PËRDORIMIN E FONDIT TË
VEÇANTË”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 18 të ligjit nr.8549, datë 11.11.1999 “Statusi i nëpunësit civil”, të nenit 5/1 të ligjit nr.8487, datë 13.5.1999 “Për kompetencat për caktimin e pagave të punës”, të ndryshuar, dhe të ligjit nr.9936, datë 26.6.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, me propozimin e Ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Pas pikës 6 të vendimit nr.1151, datë 25.11.2009 të Këshillit të Ministrave, shtohet pika 6/1, me këtë përmbajtje:

“6/1. Përgjashtimisht, për vitin 2009, fondi i veçantë i planifikuar të përdoret vetëm për shpërblimin, deri në 15 000 (pesëmbëdhjetë mijë) lekë, për të gjithë punonjësit mbështetës, pozicionet e të cilëve nuk kërkojnë, detyrimisht, arsimin e lartë, dhe që paguhën sipas sistemeve me 10, 14 dhe 22 klasa, ndërsa, deri në masën 10 000 (dhjetë mijë) lekë, për të gjithë punonjësit e tjerë.”.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha